



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2021:125785

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05820404

C.nr.459/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN-Departamenti i Përgjithshëm, në përbërje prej gjyqtarit Zenel Tasholli, gjyqtar individual, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.. S..nga fsh.B.. i Z.. K.L... të cilin me autorizim e përfaqëson Marigona Gashi av në Lipjan, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Lipjan, me objekt kontesti kompensim i të ardhurave në bazë të kualifikimit, jashtë seance gjyqësore, me dt.12.06.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

I.APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit Sh..S.. nga fsh.B.. i Z..K.L.. si e bazuar, dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Lipjanit-DKA, që t'ia paguaj paditësit në emër të kompensimit shtesë të të ardhurave personale për kualifikim 27% të pagës bazë, për periudhën nga data 18.06.2018-31.01.2023, përkatësisht për 56 muaj, t'ia paguajë nga 55.35€, apo në shumë të përgjithshme **3,099.60 €**, me kamatë ligjore 8 %, e llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë dt.18.06.2021 e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

II. Detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë 248.00 €, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

E autorizuar e paditësit, me datë 18.06.2021, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi i diferencës në shtesë në pagë në emër të kualifikimit. Me padi, ka theksuar se paditësi është i punësuar si mësimdhënës në ShFMU" N..B.." në fsh.B...ku vazhdon të punojë edhe sot.

Me parashtresën për precizim të dt.30.04.2024 ka theksuar se sa i përket kërkespadiës, paditësi është me diplomë bachelor për të cilin fakt i takon shtesa e të ardhurave personale apo 27 % e pagës bazë në muaj edhe atë, në përputhje me Ligjin e Punës dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK), ndërsa e paditura e ka paguar atë vetëm 58.32 €, duke i mbetur borxh nga 55.35 € për muaj, nga gjykata ka kërkuar që në emër të kompensimit shtesë të të ardhurave personale për kualifikim, për periudhën nga data 18.06.2018-31.01.2023, përkatësisht për 56 muaj, t'ia paguajë shumën 3,099.60 €, si dhe kamaten nga dita e paraqitjes së padisë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, përkatësisht shumën 104 € për përpilimin e padisë, 104.00€ për precizimin e kërkespadiës dhe për taksën gjyqësore për padi.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditëses e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi. E paditura përmes përgjigjes së saj në padi të parashtruar me datë 23.05.2023 e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkespadiës dhe se sipas nenit 90 pika 5 të Ligjit 03/L212 të Punës në të cilën thirret paditësi, ku thuhet se marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshje të tilla kolektive e që në rastin konkret e paditura Komuna e Lipjanit si punëdhënëse e paditësit nuk është nënshkruese e kësaj marrëveshje-kontratës kolektive në të cilën është thirrur pala paditëse. Poashtu nëse merret parasysh Kontrata Kolektive në nenin 46 par.2 shprehimisht thotë se pagesa e tillë si për kompensimin e ushqimit bëhet brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, e që konsideron se nuk janë plotësuar këto kushte, sepse të paditues nuk i janë ndarë mjete financiare nga institucionet nënshkruese të Kontratës Kolektive. Poashtu sa i përket kualifikimit dhe gradimit ju paguhen në bazë të dispozitve ligjore eventuale në listën e pagave e nga kjo nuk mund të vihet në përfundim që ka legjitimitet real pasiv lidhur me pagesat shtesë për kalifikim, por është kompetencë e nivelit të pushtetit qendror. I ka propozuar gjykatës që konform dispozitave ligjore të LK-së nenit 399 par.1 dhe 2 padinë e paditësit ta refuzon si të pabazuar-e pathemeltë.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), me të cilin përcaktohet se: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesë padinë”* dhe në rastin konkret, ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar pasi që gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadija e paditësit, pasi themelësia e kërkesëpadiës është e bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 01/33, të datës 29.08.2008.

Gjykata ka gjetur se asnjë nga faktet e paraqitura në padi nuk janë kontestuese, se paditësja është mësimdhënësi i kualifikuar me titull bachelor i programit fillor, paga bazë e të cilës është 421.00 €, ndërsa nga e paditura është kompensuar vetëm pjesërisht apo më saktë vetëm nga 58.32€ në muaj, duke i mbetur kështu borxh nga 55.35€ për muaj, fakte këto të mbështetura kontrata e punës nr. prot.04-112-813-....e datës 01.09.2016, dhe diploma e lëshuar nga Universitetit i Prishtinës”H.. P...”-Fakulteti i Edukimit në Prishtinë me titull bachelor i programit fillor , prova këto vendimtare për vendosje në këtë çështje kontestimore, pasi janë lëshuar nga organi kompetent, këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës, duke provuar kështu saktësinë e thënieve në këto dokumente, ashtu siç është paraparë në nenin 329.1 të LPK-së.

Duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare e as gjendjen faktike por vetëm bazën e kërkesëpadsisë, gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor, pasi themelësia e kërkesëpadsisë së paditësit, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del e mbështetur në dispozitat e nenit 55. 1 të Ligjit të Punës që përcakton se: “I punësuari ka të drejtë në pagë e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90. 5 i cili ka përcaktuar: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”, lidhur me dispozitat e KKAK-së së datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, përkatësisht neni 3. 2 i cili ka përcaktuar se: “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratën Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”. Në Vendimin e Qeverisë nr. 01/33, të datës 29.08.2008, në fuqi deri me datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik nr. 08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësit, drejtorët, zëvendës drejtorët dhe bashkëpunorët profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike 19 %, me diplomë universitare 3 dhe 4 vjeçar 27 % dhe me diplomë të 5 vjeçare, master dhe doktoraturë 35 % të pagës bazë. Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimitlicencimit, është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 214/2023, të datës 05.10.2023.

Në këtë çështje kontestimore, gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar paditëses pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor sepse e ka paguar atë vetëm pjesërisht ndërsa i ka mbetur borxh nga 55.35€ për çdo muaj, pasi sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë është dashur të paguhet 27 % të pagës bazë, e për këtë arsye e detyroi të paditurën si në pikën i të dispozitivit të aktgjykimit.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës lidhur me faktin e zbatimit ose jo të kontratës kolektive, gjykata i gjeti të pa bazuara këto pretendime, pasi në rastin konkret baza juridike e kërkesës së paditësit buron nga Vendimi i Qeverisë. Edhe pretendimin se paditësja është pranuar në punë sipas këtij kualifikimi dhe në kontratën e saj të punës përcaktohen përqindjet sipas kualifikimit, për gjykatën ishte fakt jo relevant për këtë çështje kontestuese pasi përqindjet sipas kritereve të licencimit të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë dhe në kontratë të punës kanë dallim mes vete dhe mësimdhënësit nuk kompensohen sipas këtyre kritereve. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të palës së paditur se nuk ka legjitimitet real pasiv për të qenë palë në procedurë dhe se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk e obligon të paditurën, por nivelin e pushtetit qendor, pasi që vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedhë se obligimi për përmbushjen e të drejtave të punësuarve të parapara me këtë kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura, andaj edhe ka legjitimitet real pasiv për të qenë palë e paditur në procedurën konkrete kontestimore dhe në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë. Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u mbështetur në nenin 449 lidhur me nenin 452.1 dhe 463.1 të LPK-së, pasi e paditura e ka humbur kontestin dhe për këtë arsye u detyrua të paguajë shpenzimet e paditësit edhe atë, për përpilimin e padisë shumë prej 104 €, për precizimin e kërkesëpadisë shumë prej 104.00€ dhe për taksën gjyqësore për padi shumë prej 40.00 €.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.459/2021 me datën 12.06.2024

G j y q t a r i
Zenel Tasholli

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.